

VENDIM
Nr.375, datë 8.4.2009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DISA TRUPAVE DHE AUTOMJETEVE
USHTARAKE SLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 20 prill 2009, të 1 (një) automjeti dhe 5 (pesë) trupave ushtarake sllovene.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 20 prill 2009, të 2 (dy) automjeteve dhe 7 (shtatë) trupave ushtarake sllovene.

3. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 30 prill 2009, të 2 (dy) automjeteve dhe 9 (nëntë) trupave ushtarake sllovene.

4. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 30 prill 2009, të 1 (një) automjeti dhe 3 (tre) trupave ushtarake sllovene.

5. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për trupat dhe automjetet tranzituese sipas pikës 1 dhe 3 të këtij vendimi është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është Porti i Durrësit.

6. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për trupat dhe automjetet tranzituese sipas pikës 2 dhe 4 të këtij vendimi, është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

7. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përta i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përta i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

8. Automjetet dhe trupat ushtarake sllovene, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

9. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha